

KOMUNITETI MYZEQAR U GATUA NË MAGJEN E MIKPRITJES BUJARE

Andrea LIKO

Studiues, Akademia “Rrënjët Tona”

PËRMBLEDHJE

Nga tematika e gjërë e konferencës, unë përzgjedha të shpreh disa mendime për mikpritjen dhe bujarinë, pasuri të etnokulturës shpirtërore në Myzeqe. Dhe dua t’a nënvizoj qartë që në fillim: komunitet myzeqar quaj të gjithë ata, të cilët jetojnë aty prej një shekulli e më shumë, pavarësisht origjinës, që është e degëzuar cep më cep trojeve shqiptare. Ata u bënë bashkë në Myzeqe sipas aksiomës së njohur, fatet e njëjta i afrojnë popujt. Ishte koha kur fshatrat e tokat qenë ende të perëndisë, pa u kthyer në çiflik. Në fjalorë, në kanune, nga Konica, Grameno, Bajroni, Gjergj Fishta, Durhami, Liku, Kadareja e të tjerë, mikpritja e bujaria ndër ne është shpalosur e vlerësuar nga A-ja tek Zh-ja. Me gjithë respektin për ta, citime kam pak sepse këtu dua të sjell diçka gatuar me miell nga magjja ime. Mbase u pëlqen dhe e shijoni.

Fjalë kyçe: bujar, bese, nuse, byrazer, myzeqar.

ABSTRACT

From the broad theme of the conference, I chose to express some thoughts on the hospitality and generosity, the richness of the spiritual ethnoculture in Myzeqe. And I want to underline it clearly from the beginning: I call the myzeqar community all those who have lived there for a century or more, regardless of their origin, which is branched from one corner of Albanian lands to another. They came together in Myzeqe according to the well-known axiom: the same destinies bring peoples closer. It was the time when the villages and lands were still of god, without turning into manor. In dictionaries, in the canons, from Konica, Grameno, Bajroni, Gjergj Fishta, Durhami, Liku, Kadareja and others, the hospitality and generosity among us is revealed and appreciated from A to Zh. With all due respect to them, I have few quotes because here I want to bring something cooked with flour from my magic. Maybe you like it and enjoy it.

Key words: generous, trust, bride, brother, native born.

KOMUNITETI MYZEQAR U GATUA NË MAGJEN E MIKPRITJES BUJARE

Gati në të gjithë rastet kur flitet për mikpritjen, shembujt jepen nga pritja e dikujt që troket në portë, rrugëtar që ngjan si njeri në nevojë, të cilin halli apo detyra e kthen në mik për një vakt, për një natë apo diçka më shumë. Ose miqësitë e njohura afatgjata, të fituara sipas praktikave shekullore me lidhje gjaku, martesë etj. Në ato momente, për të zotin e shtëpisë, miku që troket në derë mund të përqsë edhe me një gjysëm hyjni, siç thotë Kadareja. Në mitologjinë greke, vet Zeusi mbahej si mbrojtës i miqve. Se si veprohet në raste të tilla, këtë kanuni e jep taksative e me një gjysëm rreshti shtëpia e shqiptarit asht e zotit dhe e mikut. Dhe pastaj e shpjegon fije e për pe në të gjithë kreun e 18^{të}.(1) Edhe në familjet myzeqare, paçka se për shkak të pozicionin tranzit njerëz në hallë trokisnin më rrallë, të gjitha shtëpitë, ku më shumë e ku më pak, e kishin odën, dhomën e mikut, shtresat e tij dhe drutë në oxhak. Diçka më shumë kur vinte një mik, i zoti i shtëpisë, sipas takatit, thërriste edhe vëllezërit apo ndonjë fqinj, që i ardhuri të ndjehej sa më mirë. Dhe, më tej kur përcillej, miku s’kishte nevojë për besë e për roje, si në malësi,

kryesisht në veri. Miku mbase kishte nevojë për pak ushqim me vete dhe zonja e shtëpisë nuk e harronte kurrë këtë.

Mjafton të kujtojmë dy udhëtimet e famshme brenda një jave baltrave të Myzeqesë në nëntorin e vitit 1920. Ndërsa Ismail Qemali, ecte me karrocë nga Boshtova në Libofshë, Isa Boletini, 40 km më në lindje, zbriti kodrave të Darsisë e për të kaluar natën, për t'u ushqyer e shlodhur, qëndroi në Imshtë, në konakët e fisit të kamur Xhindole. Asgjë nuk u mungoi dhe asnjë gjemb nuk u hyri në këmbë, ndërsa fshatarët e Myzeqesë vetëm u bënë nderet miqve, pa e ditur fare se po shkruanin historinë. Vërtet, një akt për t'u mburrur. Mirëpo, si e tillë, pjesë e etnokulturës, kjo sjellje njerëzore gjendet edhe në Kinë, edhe në Kanada, edhe tek grekët, edhe tek eskimezët. Mirë bëjmë që e lartësojmë këtë cilësi si vlerë të jetës tradicionale shqiptare, sepse e tillë ka qënë në shekuj. Por “gjella me kripë e kripa me karar”. Ca fjalë të bukura më tepër nuk e bëjnë lirin më të madh e qumështin më të bardhë. Dihet që fshatrat e fushës në Lushnjë, për shkak të gjendjes së tokës nën ujë dhe ndërrimit të shpeshhtë të shtretërve të lumenjve, kanë nisur të krijohen si qendra të banuara diçka më vonë, nga rreth shtatë shekuj më parë Ardenica e deri në vitet pas Luftës së Dytë Botërore: Savra, Gjaza, etj. Të gjitha këto qendra janë plot dëshmi të sjelljes njerëzore të fisnikëve mikpritës, të dorës së zgjatur dhe kujdesit si një vëlla i madh, si “lala”. Këtu do të ndalem. Pasuria e fakteve dhe zinxhiri i artë i dëshmimeve, vetëm e përforcojnë bindjen se komuniteti i sotëm myzeqar, aq shumë heterogjen në gjenezën e tij, është gatuar në magjen e madhe të mikpritjes e bujarisë dhe është pjekur në vatrat e ngrohta të zemrave të bardha. Duket se shkrintari i madh, Honore de Balzak e ka njohur një realitet të përafërt, kur vërente se fatkeqësia është ndoshta hallka më e fortë që lidh njerëzit.

Sipas Edit Durham, e cila kaloi një ditë - natë në Shtyllas e në Apoloni, që në fund të shekullit XIX, në Myzeqe fiset qenë shturur. Studimet tona tregojnë se si i tillë, klasik e i strukturuar pra, atje ky sistem as nuk ka ekzistuar që në fillim, që kur ka nisur kjo jetë që vijon edhe sot pa ndërprerje. Sepse vendbanimet në fushë lindën pak e nga pak dhe banorët erdhën njëri pas tjetrit, deri një apo dy kurorë njëherësh. Kaq të largët e të panjohur ishin në gjak e në origjinën e tyre, sa vajzat e vyera të fshatit martoheshin po aty, në mos po edhe me fqinj, krejt ndryshe nga veriorët, që e kishin të ndaluar të martoheshin brenda një bajraku. Madje, ndonjë mbiemër u shtua në saje të një dukurie tejet origjinale. Dikush që vinte më vonë, mësonte cili ishte fisi më i fortë dhe merrte mbiemrin e tij. Në qytetin e Lushnjës, fjala vjen, është një lagje e tërë e hershme e Çelëve. Mirëpo ata, as në fillimet e tyre nuk kanë qënë i njëjti fis e as nga e njëjta zonë. Në fshatin Rrapëz ka disa familje me mbiemrin Gjini. Mirëpo i pari i tyre, siç e përmend edhe Fan Noli, ishte djali që erdhi në barkun e nënës e nën terrorin osman, fëmija i Gjinit, fisnikut shkodran të Skënderbeut, i cili u detyrua të largohet në Itali pas vdekjes së Kryetrimt. Të tjera familje, që morën këtë mbiemër, erdhën më vonë e bënë jetë tjetër.

Ndërsa në Libofshë, për shembull, prej dy apo tre shekujsh jetojnë vendas e vllahë, krutan e minoritarë, skraparlinj e kosovarë, boshnjakë e devollinj. Aty ka patur mbiemra që nuk kishin asnjë lidhje me vendasit e hershëm, por që shpejt ishin “më vendas se vendasit”, duke bërë të tyret cilësitë e mira të tyre. Dhe ky komunitet, si një liqen ujëngrohtë pranë detit, pavarësisht përrenjve prurës, bashkëjeton në harmoni; tashmë është bërë një me krushqi e lidhje të tjera të shumta, të cilat i kanë bërë njerëzit kushërinj e të afërm me njëri-tjetrin. Pse ka ndodhur kjo? Kadareja, që ka jetuar me periudha atje, që në vitet '60, vëren: “kujt do që ka qënë në Myzeqe, i ka rënë në sy natyra e gjerë e këtyre njerëzve. Për ta janë të huaja arroganca, brutaliteti, vaniteti, etja për t'u dukur, për t'u kapërditur, mania për t'u mburrur me gjëra që nuk i kanë, llafet e kota”.

Fjala vjen, fare nuk e dinin njerëzit në Eskaj se Zikot, Sanxhakët, Zeqot, etj., dikur paskan ardhur nga Skrapari. Se Këmbora e Myftiu, Sylarët apo Banot në Ngurrëz kishin ardhur dikur e nga larg. Sepse ata u bënë një me vendasit, të cilët u treguan mikpritës e bujarë, bashkëjetues korrekt në harmoni. Sepse, në fund të fundit, të gjithë ishin bashkëvuajtës e i kishte mbledhur aty i njëjti hall të gjenin tokë për të mbijetuar. Dhe Myzeqëja dhuronte përditë ngastra të buta toke e falte dashuri për rishtarët. Jo se myzeqarët nuk nevikoseshin, nuk nxeheshin e nuk shpërthenin në inat. Jeta e vështirë që bënë ishte një nxitëse e madhe e gjendjeve të tilla. Por edhe përvoja ishte një mësuese edhe më e madhe për të frenuar “revanin e mendjes”. Nëse duhej zjarri i kaminës për të nxehur një myzeqar, pastaj duhej uji i dhjetë puseve për ta fikur. Por ata e dinin kur duhej të ndodhte kështu, kur ishin përballë armikut dhe luheshin fatet e atdheut. Ndërsa ata të këputur që çanin baltën apo drizën ishin në hall të madh dhe do t’u mjaftonte trinia e shënjtë e mikpritjes “Bukë e kripë e zemër” që të shpresonin për mbijetesë. Shprehje e pashoqe e bujarisë së myzeqarëve është Kongresi Kombëtar i Lushnjës, i janarit 1920. Përpos patriotizmit fisnik dhe trimërisë së të urtit, atëherë lushnjarët u shfaqën mikpritës e bujarë kalorsiakë. Qyteti me vetëm 2400 banorë, strehoi, ushqeu e rrethoi me ngrohtësi mbi 2500 shpirt të ardhur nga veriu e jugu i vendit. Ndërsa në shkurt secili prej tyre qe kthyer në të përditshmen e vet halle madhe, urtësisht e pa mburrje. Nuk pati as gjokse të bërë gropë, as koka përtpjetë.

Zoti Tafil Boletini, ishte dy herë nënprefekt në Lushnjë. Pas shkarkimit nga presidenti Hamet Zogu, më 1925, ai shkruan: Bashë në këtë situatë kritike, populli i Lushnjës më duel përballë, pa kurrfarë frige, e më thanë: “Veç mos u mërëz, se na kje ne. Edhe me tamam, burrninë e bujarinë e tyne e treguen me vepra. Qe një rast konkret. Nji ditë pazari, pyeta : “Sa po shitet gruni sod?” Po kur Taip Ngurrza me shokë: “Ç’doni me grunin?” Due me ble pak grun, - u them. E ata: “ Ik, ore në shtëpi. Populli i Lushnjës gjallë e Tafil Boletini me ble grun. Kjo gja z’bahet kurrë”. Dhe nuk më lanë me ble. Kur ma vonë shkova n’shpi, e gjeta nje thes plot me grure e tjera”. Kush e njuh sadopak udhën e krijimit të fshatrave në Myzeqe, me siguri është ndeshur me historinë e “njerëzve në nevojë”. Është një tjetër dëshmi origjinale e bujarisë epike të zonës. Një shekull e ca më parë, sidomos pas Shpalljes së Pavarësisë, fshatrave endeshin plot djem apo edhe ndonjë familje e vobektë, pa ndihmë e pa të afërm . Kujdesja e njerëzve të mirë nuk e la drapërin e vdekjes të binte mbi ta. Vetëm vite e vite më vonë u mësua ç’kishte ndodhur. Në Lumth, për shembull, nën një çati e me mbiemrin Kaçeli ishin 3 – 4 familje. Siç doli kur u bë regjistrimi i ri, asnjëri nuk e kishte atë mbiemër, thjesht ishin strehuar tek njëri-tjetri dhe dikush kishte thënë “ si kaçënjtë”. Por ama, vite të tëra ata jetuan në harmoni me njëri-tjetrin, sa që të gjithë i dinin një familje. Po në këtë fshat, si dhe ne të tjerë, mbetën disa djem fukarenj e pa mbështetje që ndërsa bënë bariun, shërbëtorin etj, rriteshin. Pleqtë e fshatit i birësuan, ata krijuan aty familje dhe askush nuk e mendonte të pyeste ç’mbiemër kishin të tyren. Vetëm kur birësuesit ndërruan jetë, aty nga vitet ’70, në fshat lindën familjet e reja. Madje ecej edhe më tej. Për integrimin e tyre të plotë, me qëllim që ata të ndjeheshin të barabartë, përdorej tradita e bukur e vëlla – motër në ungjill, që në Myzeqe i thoshin “dadë byazeri”.

Nuset e reja sa vinin “lidheshin” kështu në kishë e mbi ungjill me djem të vegjël në fshat dhe kjo miqësi barazohej me krushqinë apo kumbaren. Dhe më shumë shkonin për ditë festash tek këta, e trajtoheshin më mirë, madje sillnin më shumë gëzim, se sa tek gjaku i tyre. Kur largoheshin, në darkë apo të nesërmen, edhe shtëpitë ishin pranë e pranë, miqëve u mbushej mësalla me pak nga çdo gjë prej atyre që ishin konsumuar në sofër. Grupi i tretë i njerëzve në nevojë, ishin familje nga Shpati, nga Sulova, Dumreja apo zona të tjera, të cilat kishin rënë në gjak dhe rendnin të fshiheshin në Myzeqe. Atyre u jepej çdo ndihmë dhe sidomos u lirohej tokë veçan, në thellësi të pyllit, që të mos i gjente hasmi. Dijetari i madh i

antikitetit, Platoni thoshte që nuk ka detyrim më të shënjtë se sa mikpritja dhe bujaria. Kjo traditë vijoi edhe në vitet e diktaturës komuniste. Fare pak myzeqarë u futën burgjeve “për një llaf goje”. Sepse ata nuk e spiunonin njëri – tjetrin, madje as të internuarit, me të cilët punonin në të njëjtën brigadë në bujqësi. Natyrisht, myzeqarët nuk ishin ëngjëj, as të gjithë fisnikë. Por në shumicë ata ishin zotërinj të vërtetë. Ata betoheshin “për atë zot”, por më shpesh betoheshin “për këtë tokë”, “për këtë bukë”, “për këtë zjarr”. Toka, buka dhe streha ishin edhe nevojat e para të atij që vinte. Ngastrat e familjeve rrallë ndaheshin me gardhe, madje nuk u gjet asnjë gur sinori. Por rrallë, shumë – shumë rrallë ndeshej hajnia, vjedhja në tokat e njëri – tjetrit. Ndërsa po të të humbiste një dele, në darkë e kishe në oborr. Pa sherre, pa krisma, ama edhe pa mburrje. Gratë njihnin edhe pulat e fqinjës dhe nuk i ngatërronin as vezët, as zogjtë që gjenin gardheve pa fund, përkundrazi, eshperonin bujarisht. Dhe kjo ishte një vlerë e pashoqe, që nxiste të ardhurit për të afruar edhe të tjerët, vëllezërit, krushqit, kumbaret. Në fshatrat dhe në qytetin e Lushnjës edhe sot gjenden plot shtëpi private të të ardhurve, ndërtuara në oborrit apo bahçen e një vendasi, dhuruar thjesht, për miqësi prej njohjes së mëparshme apo kur sillnin delet për dimërim. Nuk di të ketë raste të tilla në botë. Njëqind e ca vite më parë, në Lushnjë kjo ishte normale. Kanuni e parasheh edhe këtë rast, po lushnjarët nuk e dinin këtë rregull. Ata kishin rregullat e zemrës e të shpirtit. Ndaj sot bëjnë çudi kur dëgjojnë “mos na prekni Dibrën”, “Vjosa është e jona”, “Osumi na takon ne”, etj. Dakort, njerëzit kanë nevojë për ndërjegjësim kur është fjala për ruajtjen e natyrës dhe bukurive të saj. Mirëpo, me këtë logjikë, as ne nuk do ishim mbledhur këtu, sepse që herët Tirana duhet të ishte vetëm e tiranasve. Pastaj, Valbona e Dibra, Vjosa e Skrapari atje janë. Ata që sot kanë mbushur Tiranën apo Durrësin, Lushnjën, Vlorën apo Fierin, atje i kanë tokat e shtëpitë dhe mund të shkojnë. Nuk është shprehje e ndonjë dashurie të madhe për vendlindjen tek kujtojnë “byrekun që bënte nënë Fatua”, apo “hijen e burimit tek arrat me rrush”.

Mjafton të jetosh atje, natyra do të jetë më e mbrojtur dhe ushqimet bio nuk do të mungojnë kurrë. Madje, siç thonë shpesh me krenari, atje edhe mishi është më i shijshëm, edhe uji pikon mjaltë edhe arrat janë shëndet dhe sherebeli e çaji janë me shumicë. Kështu do të kishim natyrë më të kultivuar, disa miliona kokë bagëti më shumë, më tepër fruta, mjaltë, mish e bulmet. Apo i ha merakun se nuk kemi ku e çojmë prodhimin. Pa do të duheshin edhe disa mijëra blegtorë, veterinerë, inxhinierë teknologë, ekonomistë dhe zona të tëra nuk do të ishin shpopulluar. Atje, edhe mjekët e arsimtarët do të merrnin të njëjtat rroga si në qytete, në mos më shumë. Natyrisht, gjenden plot teori e argumente që mund t’i justifikojnë shoqatat, individët apo grupet e njerëzve. Mundet, është botë interesash. Por më duket se asgjë parimore, asgjë kombëtare apo patriotike nuk gjej gjatë ballafaqimit. Nuk më lë historia që në krye të herjes edhe atje jetonin njerëz. Malet nuk janë aleat vetëm kur do të fshihesh prej armikut. As për t’u treguar i përgjëruar për vendlindjen e i përvëlur për natyrën. Fshatrat e Myzeqesë nuk janë braktisur kësisoj. Besoj se për të gjithë është e njohur Vallja Dyshe Myzeqare. Specialistët e fushës japin vlerësime të shumta e maksimale për të, secili më vete. Sidomos kur e shohin të ekzekutohet aq bukur nga burrat veshur me kostumin tradicional. Dhe të gjithë janë në një mendje ajo valle bashkon e bën një njeriun dhe jetën, punën dhe gëzimin, të lidhura ngusht me tokën. Kjo, pra, dashuria për tokën dhe jeta me punë është ashta e tërë sjelljes së tyre shekullore. Ai përqaftim në fund të valles flet sa njëmijë fjalë. Në shekuj, asnjë myzeqar nuk e kërkoi jetën më të mirë në fshatrat e Mesaplikut apo të Gorë – Oparit, të Tomoricës apo Sulovës, Dishnicës apo Çermenikës. Asnjëherë, asnjë familje lushnjare nuk e la truallin e përbaltur të vendlindjes, pavarësisht përmytjeve, malarjes, taksave, dhunës së pushtimit apo presionit për ndryshimin e besimit fetar, etj.

Mbijetesa ishte pema shekullore, e cila mbeti përherë e gjelbër në oborret e tyre. Tek ata që erdhën nga larg, myzeqarët zbuluan në shumicë pikërisht këto cilësi plot vlera – dashurinë për tokën e punën dhe ky

themel i fortë mjaftoi për të ngritur ndërtesën shekullore të jetës së përbashkët. Dhe të duket sikur po flasim për kohë të shkuara. Gjenezat vërtet është e hershme, por kjo sjellje në Myzeqe është edhe sot, sepse edhe sot në ato fshatra vetëm vijnë e vijnë familje në nevojë nga Veriu dhe Gramshi, nga malësia e Beratit, e Korçës, e Librazhdit etj. Le të japim ndonjë shembull. Në fillim të viteve '90, në Bishqethëm, në Lumth, Rrapëz etj, erdhën familje dibrane, kryesisht nga Lura. Kooperativat nisën të shpërbëhen dhe filloi ndarja e tokës 4,2 dynym për frymë. Të ardhurit nuk arritën të bëhen anëtarë të kooperativës, pra, nuk përfitonin tokë sipas Ligjit 7501. Tokën e tyre e kishin, madje edhe e kanë andej nga erdhën dhe nuk ia falin njeriu. Ata, të ndjerë në nevojë, u thanë vendasve: “Ne nuk ikim, do të punojmë argatë në tokat tuaja.”. Myzeqarët, si myzeqarët; mot – mot e brez pas brezi, njëlloj. U dhanë edhe atyre të njëjtën sipërfaqe. Shkelën ligjin e shtetit, por nuk zhbënë vlerat e bukura tradicionale të mikpritjes dhe bujarisë. Fillimisht toka ishte e paktë, kushtet qenë tejet të vështira dhe jetesa aspak e kënaqshme. Fshatrat përmyteshin çdo vit dhe pastaj thatësira sillte krizën e bukës. Malarja ishte në abiatin e vet dhe ethet bënë kërdrinë. Edhe sherret e përplasjet me pushtuesit osmanë, sidomos për pronësinë apo taksat, shpesh sillnin humbje jete e largime. Natyrisht, kjo ishte njëlloj si për vendasit e hershëm, ashtu edhe për të ardhurit. Ata i dinin këto, e njihnin këtë realitet. Por prapë, vinin e vendoseshin sopeve e korijsve. Sepse mikpritja e vendasve, dora e ngrohtë, besnikëria dhe shpirti i tyre i pastër kanë qënë një nxitje më vete dhe një garanci e madhe për mbijetesë. Pavarësisht vështirësive të skajshme, fshatrat në Myzeqe e kanë ruajtur vazhdimësinë sepse njerëzit u lodhën, por nuk u ndalën vujtën shumë, por duruan edhe më shumë, u rrëzuan, po prapë u ngritën; sa më shumë u bënë, aq më fort u bashkuan, sa më ngrohtë i pritën të ardhurit, aq më shpejt u dhanë atyre cilëtitë e veta më të mira; sa më ashpër u goditën, aq më kryelartë qëndruan. Nëpër shekuj, bashkë me të ardhurit, ata i përsosën edhe më tej disa nga tiparet e tyre të vyera, qëndresën besnike të guximitarit të urtë, lidhjen e pashoqe me tokën dhe punën, bujarinë fisnike të njeriut shpirtgjërë, dashurinë e shënjtë për jetën dhe familjen, mendjen e hapur dhe shikimin e qartë për të nesërmen. Më parë se të vinin gishtin tek arma, që nuk u mungonte, ata kanë gjykuar të zgjasin dorën për miqësi. Më parë se të trashnin zërin, myzeqarët e ngrohën atë brenda shpirtit. Nuk patën kanun a rregulla të shkruara për këto gjera, por i përmbushën më mirë se kushdo e kudo tjetër.

Si rregull, në një kohë të gjatë bashkëjetese, vendasit më të hershëm dhe ata që vijnë më vonë japin e marrin nga njëri – tjetri, shfaqet trysni e qëllimshme, në mos po, mund të arrihet dhe asimilimi. Nuk ka ndodhur kjo gjë në fshatrat e fushës së Lushnjës. Me kalimin e dekadave, edhe pse kanë ruajtur diçka nga normat e veta, të ardhurit kanë përqaftuar tërësisht traditat e vendasve, veçmas lidhjen gordiane me tokën dhe punën, ruajtjen e familjes, të folurën e butë, ritet fetare, deri edhe këngët e vallet myzeqare. Dhe kjo kuptohet i kanë bërë të tyret sepse u kanë pëlqyer e i kanë quajtur të vlefshme. Kanë mjaftuar për të gjithë. Ishin gatuar me durim në magjet myzeqare dhe kishin qënë faktor i fortë i qëndresës shekullore. Prej vitesh nuk bëhej dot dallimi midis të krishterëve vendas dhe vllahëve, madje kjo as që përmendej fare. Çamët e vuajtur, devollinjtë punëtorë dhe myzeqarët e hershëm u lidhën në miqësi e krushqi, ndërsa kosovarët rrallë shfaqeshin të rrëmbyer, gjaknxehtë apo kryelartë, tipare me të cilat erdhën plot 100 vite më parë. Për t’iu referuar edhe një herë shkrimtarit tonë të madh, po shfletoj librin e studiuesit të njohur myzeqar, zotit Jovan Jano. Tek “Fisnikëri myzeqare” ai tregon se në bisedë në Ardenicë, kolosi i letrave shqipe ka thënë: “Kam jetuar e punuar në këtë zonë në vitet '60. Ka njerëz shumë të perzëmërt dhe fisnikë. Për mua, Myzeqëja është e ardhmja e Shqipërisë dhe myzeqarët janë njerëzit e së ardhmes, sepse janë punëtorë, arsmidashës dhe tolerantë. Tek ata nuk ekzistojnë paragjykimet e së kaluarës dhe nuk e kanë ndjenjën e të dominuarit mbi të tjerët. Të tillë i kam njohur e të tillë janë”. (6)

PËRFUNDIME

1. Zona e Lushnjës pati shansin të jetë në veriperëndim të Jugut të vendit dhe në juglindje të Shqipërisë së Mesme.
2. Në këto kushte, ajo ka dhënë e ka marrë, ka bërë krushqi, miqësi e tregti në veri e në jug, njëlloj.
3. Në Lushnjë janë qindra familje nga Kukësi e dhjetëra nga Përmeti, pra ka përzjerje kulturash, gjë që nuk mund të thuhet për Kukësin me Përmetin.
4. Në Lushnjë, disa qindra familje nga Librazhdi e nga Tepelena bashkëjetojnë normalisht, por në qytetet përkatëse nuk ndodh kështu.
5. Edhe ky raport i ngushtë qindravjeçarë, edhe këto marrëdhënie të gjera shekullore janë një faktor më shumë që në zonën e Lushnjës janë përfaquar disa tipare goxha të mira: toleranca, mirëkuptimi, shmangia e mburrjeve dhe e llafeve pa bereqet.
6. A nuk është kjo Shqipëria që parashihet Kadareja? Shikoni, në vite '90, në Shqipëri u krijuan dy qeveri me bazë të gjërë, ku kërkohej tolerancë, mirëkuptim e harmoni kombëtare. Dhe vetëm në ato dy qeveri pati ministra nga Lushnja.
7. Intresant, po a nuk po këndojnë së fundi me saze popullore, si myzeqarët në shekuj, edhe Paroja nga Bënça e Tepelenës, Dulja nga malet e Skraparit, grupet nga Dibra, Kruja, Kukësi apo Tropoja.
8. Për më tepër, a nuk po kërkojmë të jemi më tolerantë, më të qetë, më punëtorë e më human me njëri-tjetrin.
9. Ja, këto tipare që luftojmë t'i shtojmë sot, janë kultivuar me kohë në fshatrat e Myzeqesë.

STUDIME MBËSHTETËSE DHE REFERENCA

1. Kanuni i Lek Dukagjinit, ALBINFORM 1993.
2. Dr. Kozma Gjini: Të vërteta të pathëna. Tiranë, 2016.
3. Ismail Kadare, "Qyteti i jugut", Tiranë, 1967.
4. Tafil Boletini, Kujtime, KLEAN, Tiranë 2011.
5. Tafil Boletini, Kujtime, KLEAN, Tiranë 2011
6. Jovan Jano "Fisnikëri myzeqare", Tiranë 2009, fq. 30.